

LIGJ
Nr.8351, datë 20.5.1998

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.7933, DATË 17.5.1995 "PËR PUNËT PUBLIKE", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8104, DATË 28.3.1996

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7933, datë 17.5.1995 "Për punët publike", ndryshuar me ligjin nr.8104, datë 28.3.1996, në nenin 1, pas fjalës "papunësisë" shtohen fjalët "dhe punëkërkuesve të papunë".

Neni 2

Neni 2 ndryshohet si vijon:

"Punët publike, në kuptimin e këtij ligji janë":

a) pjesëmarrje në punimet për zbatimin e projekteve që financohen pjesërisht ose plotësisht nga shteti dhe synojnë ndërtimin, riparimin, sistemimin dhe mirëmbajtjen e elementeve të thjeshta të infrastrukturës dhe mjediseve publike në qendra të banuara;

b) punësim i përkohshëm në subjekte shtetërore ose organizma joqeveritarë jofitimprurës, që ofrojnë shërbime shoqërisht të dobishme, ku shteti financon plotësisht ose pjesërisht pagën, kontributet për sigurime të detyrueshme dhe kosto të tjera të lidhura me këtë punësim.

Neni 3

Në fund të nenit 3, pas fjalës "papunësisë" shtohen fjalët "dhe hiqen nga lista e punëkërkuesve të papunë".

Neni 4

Në nenin 5 shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

"Këshilli i Ministrave krijon organizma të posaçëm ndërinstitucionalë për ndjekjen, bashkërendimin dhe propozimin e politikave të përgjithshme shtetërore për programet e punëve publike."

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2103, datë 22.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani